



Planuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	10 - 10	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	SKPM/SHK	6045/2022		
Shtojca Prilog Appendix				
Sasia Kolicina Quantity			113	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.735/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.735/2022 të datës 25.08.2022, të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar me autorizim nga Avokat me adresë: kundër institucionit punëdhënës Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07. 10.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.735/2022 e datës 25.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Thesarin e Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me datën 25.08.2022, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4964/2022 të datës 25.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimore për kompensimin e shtesave në mënyrë retroaktive në vlerën prej 150 Euro në muaj, prej datës 09.09.2021 deri me datë 01.08.2022, në emër të Vendimit me numër:50/2022 të datës 18.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 26.08.2022 ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 4999/2022 për përgjigje në ankesë në Këshillin



Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 07.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër të protokollit:209/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4969/2022 të datës 25.08.2022; Autorizimin e datës 25.08.2022; Vendimin e datës 18.07.2022 me numër:50/2022 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimin e datës 14.09.2021 me numër:34/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit; E-mailin e datës 28.07.2022 për ankuesin nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit me korrespondencën e bashkëngjitur prej 5 (pesë) faqesh; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.08; Përgjigjen në kërkesë të datës 07.09.2022 me numër prot:209; Akt emërimit të ankuesit të datës 30.03.2012; Akt emërimit të ankuesit të datës 16.11.2018; Vendimin e datës 04.05.2020 me numër:11/2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit; Vendimin e datës 10.07.2020 me numër:20/2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit; Vendimin për themelimin e grupit punues i datës 21.09.2021 me numër:34/2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Pagesave; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Lartë i Pagesave"; E-mailin e datës 22.07.2022 dërguar nga ankuesi për Drejtorin e Thesarit; E-mailin e datës 28.07.2022 dërguar nga E.B për Drejtorin e Thesarit me korrespondencën e bashkëngjitur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e administruara të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i provave të lëndës, ka gjetur se ankuesi sipas të Akt emërimit me numër DBNJ/DSKPK/134/2019 të datës 16.11.2018 është emëruar në pozitën "Zyrtar i Lartë Financiar i Pagesave", kurse sipas vendimit me numër:20/2022 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës me datë 10.07.2022 është caktuar zëvendësues në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Pagesave", ndërsa sipas Vendimit me numër:34/2021 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës me datë 14.09.2021 është caktuar "Kryesues i Grupit punues për Koordinim, zbatim dhe raportim të Masave sipas Vendimeve të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve bazuar në PRE".

Ankuesi, me datë 22.07.2022 i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të thesarit të Kosovës me kërkesën për kompensimin e shtesave duke iu referuar Vendimit me numër:50/2022 të datës 18.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa Drejtori i Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës me datë 28.07.2022 përmes e-mailit zyrtar i kthen ankuesit përgjigje negative me arsyetimin Vendimi i ministrit i datës 18.07.2022 me numër:50/2022 ka të bëjë me kompensimin e shtesa për anëtarët e grupeve punuese të cilat janë themeluar me vendime të Qeverisë.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dhe shqyrtuar përmbajtjen e Vendimit me numër:50/2022 të ministrit i datës 18.07.2022 Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe ka konstatuar se në pikën 1 të dispozitiv të këtij vendimi është vendosur si vijon, *citoj*: "Kryesuesit dhe Anëtarët e Komisioneve Zbatuese dhe Komisioneve të Ankesave të konstituara me qëllim të implementimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Krijuar me vendimin e Qeverisë Nr.13/19 të datës 14.07.2019, plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin





Nr.12/31 të datës 25.08.2021, plotësuar dhe ndryshuar me Vendimi Nr.01/49 të datës 17.12.2021, plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr.15/62 të datës 23.02.2022, kompensohen me shtesa si në vijim: 1.1 kryesuesi i Komisionit Zbatues për një (1) muaj punë në një komision paguhet në shumën prej 150.00 Euro (me shkronja: njëqind e pesëdhjetë euro)", ndërsa pika 4 e të njëjtit dispozitiv lidhur me kompensim retroaktiv ka përcaktuar se, *citoj*: "Pagesa e shtesës bëhet në formë retroaktive për zyrtarët e angazhuar në komisione prej muajit korrik 2021 deri në muajin korrik 2022,...", andaj mbi bazën e këtij vendimi të përcaktuar si në pikën 1 të dispozitiv të tij, pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin shtesave janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme ngase ankuesi është caktuar në grup punues përmes Vendimit numër:34/2021 të nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, ndërsa sipas Vendimit me numër:50/2022 të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i datës 18.07.2022, e drejta për kompensim u është njohur zyrtarëve të cilët janë caktuar në grupe punuese përmes Vendimeve dhe Plotësimit të Vendimeve të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, rrjedhimisht përgjigjja e datës 28.07.2022 e cila i është kthyer ankuesit nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës është e qëndrueshme dhe e drejtë.

Andaj, pas shqyrtimit shkresat e lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.735/2022**

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës/MFPT-së ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës/MFPT-së; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

